



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1197/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Donjeta Tasholli kandidate për anëtare të kuvendit komunal nga radhët e LDK-së në Lipjan, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të manipulimit me vota, për Zgjedhjet Lokale në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Donjeta Tasholli, kandidate për anëtare të kuvendit komunal në Lipjan, nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK).

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 03.12.2013 në ora 15:08 nga Donjeta Tasholli kandidate për anëtare të kuvendit komunal nga radha e LDK-së ku ka pretenduar se në bazë të rezultateve preliminare të shpallura nga KQZ-ja në këto vendvotime nr: 1301-Lipjan, nr:1307-Gadime epërme ,nr:1308e, 1322e-Dobrajë e madhe, nr:1325Q-Banullë, nr:1327-Poturofc, nr:1330-Smallushë. Dyshoj se rezultati nuk është i saktë, thuhet në pretendimet e ankuesit. Parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi ankesën gjeti se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i, konstatoi nga shkresat e lëndës se pretendimet ankimore të kandidates për anëtare të kuvendit komunale nga radha e LDK-së Donjeta Tasholli janë të pa argumentuara në fakte dhe dëshmi konkrete pasi që ankesës në fjalë nuk i ka bashkangjitur asnjë dëshmi bindëse, për tu vërtetuar për shkeljen e supozuar andaj ankesa vlerësohet si e pa bazë, duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa

Anr. 1197/2013 më datën 06.12.2013.



**Kryesuesi i Panelit
Ferit Osmani**

Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.